

## KONTRATE INDIVIDUALE PUNE

Mbeshtetur ne ligjin nr.7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise”, (i ndryshuar) lidhet kjo kontrate pune (me poshte “kontrata”) sot me date \_\_\_\_\_,

ndërmjet

Subjekti tregtar ..... me seli në ..... me numer NIPTI \_\_\_\_\_, perfaqesuar nga Z. ...., qe me poshte do te quhet **“Punedhenesi”**.,

dhe

Z/Znj. \_\_\_\_\_, i/e biri \_\_\_\_\_, lindur me \_\_\_\_\_, ne Tirane, banues/e ne Tirane, me dokument identifikimi e llojit \_\_\_\_\_ me nr. \_\_\_\_\_ leshuar me dt. \_\_\_\_\_, ne profesionin \_\_\_\_\_, i/e diplomuar me \_\_\_\_\_ me zotesi te plote per vepruar (me poshte **“Punemarresi”**),

Palet bien dakort si me poshte:

### Neni 1

#### Kushtet e Pergjithshme

1.1.Kjo kontrate individuale pune, eshte e mbeshtetur ne marreveshjen e lidhur ndermjet Punemarresit dhe Punedhenesit, per rregullimin e marredhenieve dhe kushteve te punes se punemarresit ne kete shoqeri, si dhe ne te percaktohen te drejtat dhe detyrimet e paleve.

1.2. Palet do t'i referohen:

a)dispozitave te kesaj kontrate kur ajo ka bere rregullime specifike per nje çeshtje konkrete te marredhenies se punes, ose

b)Kodit te Punes dhe akteve nenligjore qe kane dale ne zbatim te tij, nese kontrata nuk ka parashikime per çeshtje te caktuara te marredhenieve te punes.

1.3.Punëmarësi dhe Punëdhënësi zbatojnë detyrimet e përgjithshme të parashikuara në nenet 22-38 të Kodit të Punës

### Neni 2

#### Qellimi i Kontrates

Qellimi i kesaj kontrate eshte krijimi i nje marredhenie pune ndermjet Punedhenesit dhe Punemarresit i cili do te punesohet ne detyren \_\_\_\_\_, prane shoqerise \_\_\_\_\_” shpk/sh.a.

### **Neni 3**

#### **Pranimi ne pune**

3.1. Punemarresi qe do te merret ne pune, eshte i detyruar te paraqese prane Punëdhënësit \_\_\_\_\_, dokumentat e meposhtme:

Dokumentin e identifikimit;

Librezen e punes (nese ka);

Diplomen, certifikatat dhe deshmite per aftesine ne pune (nese ka);

Librezen e sigurimit shoqeror e shendetesor (nese ka);

Raport mjeksor per aftesine e tij ne pune;

Adresen e vendbanimit, dhe/ose ndonje dokument tjetër te nevojshem, qe

mund ti kerkohet nga Punedhësi sipas specifikes se vendit te punes.

### **Neni 4**

#### **Kohezgjatja e kontrates se punes**

4.1. Kjo kontrate eshte **me afat te pacaktuar/ Kontrata e punës është për një afat \_\_\_\_\_**<sup>1</sup>

4.2\_\_Punemarresi do te merret ne pune pas nje kohe prove\_\_\_\_\_ (**jo me shume se tre muaj**). Kjo kohe njihet si vjetërsi ne pune dhe punëmarrësi gjatë kësaj periudhe ka të njëjta të drejta dhe detyrime si dhe punëmarrësit e tjere, si dhe paguhet ne baze te marreveshjes me punëdhënësin. Nese punonjesi vleresohet se do të nënshkruajë ose jo një marrëdhënie juridike pune sipas pikës 4.1, ai duhet te njoftohet \_\_\_\_\_ ( te pakten 5 dite) para perfundimit te kohes se proves.

### **Neni 5**

#### **Vendi dhe Pershkrimi i punes**

Punëmarësi do të kryejë punën e tij pranë punëdhënësit, në setorin/degën/departamentin \_\_\_\_\_, në vendin e punës \_\_\_\_\_, në qytetin/njesene administrative \_\_\_\_\_.

Detyrat e Punemarresit do te perfshijne, por nuk do te kufizohen domosdoshmerisht vetem ne keto si me poshte vijojne:

---

<sup>1</sup> Lidhja e kontratës së punës për një periudhë të caktuar duhet të justifikohet me arsye objektive që lidhen me natyrën e përkohshme të detyrës, sipas nenit 140, pika 2 e Kodit të Punës

- 5.1. Punemarresi do te kryeje detyrën e ..... Ai do te angazhohet se do te jete produktiv per detyrat e mesiperme duke vene ne shfrytezim te gjitha aftesite e tij intelektuale e profesionale.
- 5.2. Punemarresi duhet te angazhohet qe do te beje gjithë perpjekjet, si dhe do te perdore eksperiencen e tij, per kryerjen me kujdes te detyrave, ne perputhje me standartet me te larta, rregullat teknike dhe profesionale te instruatuara nga punedhenesi, dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi.
- 5.3. Punemarresi eshte i detyruar, te kryeje me ndershteri detyrat e ngarkuara nga Punedhenesi, te kete nje disipline te larte, si dhe te respektoje rregulloren e brendshme, urdherat dhe udhezimet e Punedhenesit.
- 5.4 Punemarresi detyrohet te mbroje interesat e ligjshme te Punedhenesit, duke shmangur çdo dem qe mund t'i shkaktoj ketij te fundit.
- 5.5. Punemarresi eshte i detyruar te realizoj te gjitha punet dhe detyrat qe i jane percaktuar nga Punedhenesi.
- 5.6. Punemarresi eshte i detyruar re kryeje me kujdes punen qe i ngarkohet, duke perdorur sipas rregullave mjetet e punes, paisjet si dhe aparaturat ne dispozicion te tij.
- 5.7. Punemarresi gjate periudhes se kohezgjatjes se kontrates, do te kryeje detyren e tij vetem per punedhesin, si dhe i jep llogari atij per gjithcka te perfituar gjate punes ne emer te punedhenesit.
- 5.8. Punemarresi detyrohet te ruaje me besnikeri interesat e ligjshme te punedhenesit si dhe sekretet profesionale per te cilat ai ka pasur dijeni kur ka gene ne sherbim te punedhenesit.
- 5.9. Punemarresi nuk ka te drejte ti beje konkurrence punedhenesit gjate periudhes se vlefshmerise se kesaj kontrate si dhe pas perfundimit te saj.
- 5.10. Punemarresi detyrohet te zbatoje me perpikmeri rregullat dhe masat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune.
- 5.11. Punemarresi angazhohet per kryerjen e detyres personalisht. Nese Punemarresi largohet perkohesisht nga puna 5.12. Nese Punemarresi nuk deshiron te ripërterije kontraten, ai eshte i detyruar te njoftoje Punedhenesin 1 muaj para plotesimit te afatit te perfundimit te kontrates.
- 5.12. Puna qe do te kryeje punemarresi do te jetë:

---

2.

## **Neni 6**

### **Ruajtja e konfidencialitetit dhe konflikti i interesave**

6.1. Punemarresi eshte i detyruar te ruaje konfidencialitetin, dhe nuk do te zbuloje apo do te jape tek persona te trete, direkt apo indirekt, me asnje lloj mjete, çfaredo dokumenti dhe asnje informacion qe ka degjuar apo pare tek Punedhenesi, perfshire ketu edhe subjektet shteterore, pa marre me pare miratimin e Punedhenesit.

---

<sup>2</sup> Bëni nje pershkrim të detajuar të detyrave qe ai duhet te kryeje sipas pozicionit të punës

6.2. Te gjitha aktivitetet e kryera nga Punemarresi, te cilat jane te lidhura me detyren e tij jane te papajtueshme me çfaredolloj aktiviteti tjetër.

6.3. Punemarrësit nuk duhet te pranoje pa autorizimin paraprak me shkrim te Punedhënesit, asnje detyre tjetër, si dhe nuk duhet te angazhohet ne asnje aktivitet tjetër i cili mund te jete ne konflikt me detyrat e pershkruara ne nenin 5 te kesaj kontrate.

6.4. Punemarresi duhet te veproje ne çdo kohe ne interesin me te mire te Punedhënesit, gjate kryerjes se detyrave te tij dhe ne te gjitha marrëdhëniet me palet e treta, duke shmangur preferencat ndaj interesave te te tjereve me te cilet ai mund te kete çfaredo kontakti.

6.5. Punemarrësi duhet te informoje menjehere Punedhënesin per çdo ngjarje apo veprim qe shkakton apo mund te shkaktoj nje konflikt interesash.

6.6. Punemarresi ne detyren e tij duhet te ruaje konfidencialitetin e detyres se tij. Nese Punemarresi nxjerr te dhena dhe informacione te Punedhënesit, duke ia vene ne dispozicion personave te trete, ai si dhe subjekti qe kane perfituar kete informacion jane te detyruar qe t'i demshperblejne Punedhënesit demin e shkaktuar, sipas vleresimit qe bejne ekspertet e Gjykates.

## **Neni 7 Konfidencialiteti**

Ruajtja dhe Mos-nxjerja e Informacionit Konfidencial. Qofte gjate periudhes se kesaj Kontrate si edhe mbas skadences apo mbylljes se parakohshme te kontratës, Punemarresi nuk duhet te, perdori çfaredo lloj informacioni (i) i cili nuk i perket njohurise publike, ne çdo forme qofte; (ii) te marre nga punemarresi gjate kohës kur ka qene ne pune ose, (iii) te marre mbas mbylljes se kesaj Kontrate nga çdo person apo entitet e cila ka detyrim te ruaje konfidencialitetin kundrejt Punedhënesit (qe ketej e tutje, "Informacioni Konfidencial")

Si nje menyre illustrative po pa krijuar asnje limit, Informacioni Konfidencial mund te perfshije sekretet tregëtare, liste klientesh, metoda pune, mareveshje kompensimi te punojësve, praktika biznesi, plane, politika, shpikje sekrete, procese dhe perpunime informacioni, regjistrime dhe specifikime, si dhe informacione te lidhura me politikat e manaxhimit dhe planeve te Punedhënesit. Me qellim menjanimin e keqkuptimit do te konsiderohet e fshehte tregëtare, informacion me çfaredolloje permbajtje dhe e ruajtur, regjistruar ose disponueshme ne çfaredolloj forme qe pëmban te dhena te çfaredolloji ne lidhje me aktivitetin tregëtar ose te lidhura me te, te çdonjeres pale ose paleve te treta te lidhura me kete pale, te disponuara nepermjet kesaj kontrate.

## **Neni 8**

### **Pronesia Industriale**

Punemarresi bie dakort që për çdo pune dhe për të gjithat shërbimet e kryera gjate punes dhe ne funksion te saj, duke përfshirë këtu pa asnjë kufizim çdo punë kreative, software, modifikime dhe/ose përmirësime të programeve ekzistuese, teknologjive të bazave të të dhënave, kodit burim apo objekt, skicash teknike, diagrama, manuale pune dhe prodhime të tjera nën këtë Kontatë, përfaqësojnë punë të punedhënesit me qira dhe e gjithë pronësia duke përfshirë pa kufizim të drejtat e autorit do ti kalojë ekskluzivisht Punedhënesit. Në menyrë të pa revokueshme keto shërbime pune i transferon dhe i kalon të gjitha të drejtat, titujt, interesa dhe të drejtat e autorit në këto punë të dorëzuara Punedhënesit.

Palët bien dakord dhe deklarojnë se këto pune, shërbime do të rezultojnë në krijimin e programeve kompjuterike (software) në formën e kodit burim si dhe objekt, dokumentacion ku përfshirjen specifikime dhe dokumentacione të tjera teknike dhe të përdoruesve, etj. që do të jenë në pronësi të Punedhënesit.

Do te aplikohen edhe penalitete nese punemarresi vepron ne kundërshtim me kete kontrate.

## **Neni 9**

### **Paga dhe detyrimet nga paga**

7.1. Punemarresi do te marre nje page prej \_\_\_\_\_, ( \_\_\_\_\_ ) leke.

7.2. Paga i paguhet Punemarresit nje here ne muaj, ne daten \_\_\_\_\_ te muajit, duke u zbritur prej saj te gjitha detyrimet qe burojne nga legjislacioni i tatimeve dhe i sigurimeve te detyrueshme shoqerore dhe shendetesore.

7.3. Detyrimet e paguara nga Punemarresi sipas pikes 7.2, mbahen nga Punedhënesi ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## **Neni 10**

### **Koha normale e punes, mbikoha e punes dhe vendi i punes**

8.1. Koha normale e punes perbehet nga te gjitha oret e punes te percaktuara ne programin ditor, por jo me shume se 8 ore ne dite.

8.2. Koha javore normale e punes do te jete 40 ore dhe eshte e shperndare gjate kohes javore te punes ne kete menyre:

a. nga dita e hene deri ne ditën e premte prej ores .....deri ne oren....., /si dhe

b.diten e shtune prej ores ..... deri ne oren.....<sup>3</sup>

8.3. Punemarresi angazhohet qe ne cdo rast qe do ti kerkohet nga Punedhenesi te kryeje nje numer maksimal oresh shtese prej jo me shume se 8 ore ne jave. Ne keto raste punemarresi do te kompensohet me pushim shtese ose pagese shtese, sipas nenit 91 te Kodit te Punes.

8.4. Puna ne turnin e dyte nga ora 19.00 - 22.00 do te paguhet me nje shtese page prej \_\_\_\_\_% ndaj turnit te pare ( por jo me pak se 20% shtese page), dhe ne turnin e trete nga ora 22.00 - 6.00 do te paguhet me nje shtese page \_\_\_\_\_% ndaj turnit te pare ( por jo me pak se 50% shtese page).

### **Neni 11**

#### **Pushimet javore, vjetore, per festat zyrtare si dhe pushimet e tjera**

9.1.Punemarresi ka te drejten e pushimit javor prej 36 oresh nga te cilat 24 ore pa nderprerje. Pushimi javor prej 24 oresh pa nderprerje do te jete ditene \_\_\_\_\_.

9.2. Punemarresi ka te drejten e festave zyrtare te percaktuara ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

9.3 Nese punemarresit i kerkohet te punoje ditene e pushimit javor ose gjate diteve te festave zyrtare, ai do te kompensohet sipas nenit 87 te Kodit te Punes.

9.4.Punemarresi ka te drejten e pushimit vjetor sipas dispozitave te Kodit te punes. Kohezgjatja e pushimeve vjetore eshte jo me pak se 4 jave kalendarike ne vit.

9.5.Programi dhe shperndarja e pushimeve vjetore percaktohet te paktën 30 dite para nga Punedhenesi pas propozimit te Punemarresit. Pushimet vjetore jepen gjate vitit te punes, ose gjate tre mujorit te pare te vitit pasardhes, ne marreveshje me te punesuarin, por asnjehere jo me pak se 1 jave kalendarike.

9.6 Paga qe perfiton per pushimet vjetore eshte paga reale ne momentin e fillimit te periudhes se pushimeve, dhe i paguhet ne momentin e fillimit te tyre. Ne rastet kur marredheniet e punes perfundojne dhe i punesuari nuk i ka marre pushimet vjetore, atehere ai ka te drejten e nje shperblimi te barabarte me pagen e ketyre pushimeve.

9.7.Punemarresi perfiton 5 dite pushime te pagueshme ne perputhje me percaktimet e Kodit te Punes, ne rast martese te tij, ose vdekje te bashkeshortit/bashkëjetuesit, paraardhesve ose pasardhesve te tij te drejperdrejte.

---

<sup>3</sup> Nese do te ketë një shpërndarje të kohës javore të punës në 6 ditë të javës

9.8.Punemarresi perfiton jo me shume se 30 dite pushimi te papaguara, në rast sëmundjeje të rëndë të anëtarëve të familjes, bashkëjetuesit, të paraardhësve ose të pasardhësve të tij të drejtpërdrejtë, të vërtetuar me raport mjekësor.

## **Neni 12**

### **Pagesat nga semundjet dhe barre lindja**

10.1.Punemarresi ka te drejten te perfitoje pagen e tij per jo me shume se 12 dite mungesa ne vit, ne rast perkujdesje te domosdoshme per femijet ne ngarkim. Punemarresi me femije te mitur deri ne tre vjeç ka te drejte per pushim te paguar deri ne 15 dite, kur femija e tij eshte i semure, vertetuar kjo me raport mjekësor. Ai ka te drejte te perfitoje per nje periudhe shtese jo me shume se 30 dite ne vit pa pagese.

10.2. Punedhenesi mund te verifikojë:

- a. nese punemarresi perkujdeset efektivisht per femijen, si dhe
- b.raportin mjekësor te paraqitur per kujdesin e femijes, duke caktuar nje mjek tjetër.

10.3. Punemarresi ka te drejten e lejes se barre lindjes sipas percaktimeve te bera ne nenet 104/1, 105 dhe 106 te Kodit te Punes.

10.4. Nese Punemarresi nuk mund te punoje per shkak te semundjes se tij, provuar kjo me raportin mjekësor te leshuar sipas dispozitave ligjore ne fuqi, Punedhenesi i jep atij nje pagese prej: 70% te pages nese punemarresi ka deri 10 vjet pune, ose 80% te pages nese punemarresi ka mbi 10 vjet pune, per nje periudhe prej 14 ditesh te pambuluara nga sigurimet shoqerore, sipas percaktimeve te bera ne nenin 130 te Kodit te Punes.

## **Neni 13**

### **Detyrimet ndaj taksave dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetesore**

11.1.Punemarresi informohet çdo muaj për vleren e tatimit mbi te ardhurat personale qe i mbahet ne pagen e tij, ate te kontributit te sigurimeve te detyrueshme shoqerore dhe shendetesore, si dhe çdo ndalese tjetër qe mund t'i mbahet per arsye te ndryshme sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

11.2. Punedhenesi ne baze te Ligjit nr.7703, date 11.05.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar), detyrohet te paguaje çdo muaj ne fondin e sigurimit te detyrueshem shoqeror dhe sigurimit shendetesor kontributin prej 21.7% te pages kufi, ndersa Punemarresi eshte i detyruar te paguaje kontributin prej 11.2 % te pages kufi ne fondin e sigurimit te detyrueshem shoqeror dhe sigurimit shendetesor.

10.3. Punedhenesi është i detyruar të mbajë, evidentojë dhe të derdhe në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm Shoqëror dhe në atë të Sigurimit Shëndetësor, kontributet e mbajtura nga paga e Punemarresit, si edhe pjesën e kontributit që paguan Punedhenesi për ta.

#### **Neni 14** **Mbi kushtet e punës.**

Punedhenesi ka për detyrë t'i sigurojë punemarresit kushte të favorshme për punë për sigurimin dhe mbrojtjen në punë, sigurimin e kushteve higjieno-sanitare, normat e sigurimit teknik, mjetet mbrojtëse dhe të gjitha kushtet e tjera të punës që përcaktohen në dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe legjislacionit shqiptar në fuqi përfshirë dhe atë të sigurisë dhe shëndetit në punë, për veprimtarinë që ai kryen.

#### **Neni 15** **Përgjegjësitë dhe sanksionet**

13.1. Punemarresi do të mbajë përgjegjësi të plote për:

- a. ligjshmerinë, korrektesinë dhe saktësinë e veprimeve të tij gjatë ushtrimit të detyrës,
- b. për moskryerjen e plote apo të pjesshme të detyrave të tij,
- c. për moszbatim të plote apo të pjesshëm, pa shkaqe të arsyeshme të rregulloreve të brendshme, urdherave dhe udhëzimeve të Punedhenesit,
- d. sjellje në kundërshtim me rregullat gjatë kohës së kryerjes së detyrave,
- e. largimin nga puna brenda orarit të punës, për çfarëdo lloj arsyeje,
- f. demtimin e çdo pasurie të Punedhenesit, ose krijimin e mundësive për një demtim të tillë,
- g. për veprime apo vepra të kryera në punë të cilat janë në kundërshtim me rregullat etiko-morale,
- h. Mungesën pa arsye në punë

13.2. Për shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të rregulloreve, urdherave dhe udhëzimeve të Punedhenesit, ndaj Punemarresit mund të merren këto sanksione disiplinore:

- a. Ndalëse të pagesës ditore, për shkeljet e parashikuara në pikën 13.1, shkronjat "b" dhe "h" të kësaj kontrate,
- b. Keshillim;
- c. Verejtje;
- d. Verejtje me paralajmërim;
- e. Largim nga puna.

13.3. Për demtimin e çdo pasurie të Punedhenesit, Punemarresi është i detyruar të demshpërmbelje demin e shkaktuar në masën e përcaktuar në aktin e zhdemtimit të nxjerre nga Punedhenesi. Ndaj Punemarresit që ka



shkaktuar nje dem, Punedhenesi njekohesisht me kerkesen per demshperblim, ka te drejten edhe te dhenies se nje sanksioni disiplinor.

13.4.Punemarresi do te pergjigjet per demet e shkaktuara Punedhenesit si rrjedhoje e shkeljes se detyrimeve te percaktuara ne kete Kontrate dhe ne Kodin e Punes, pavaresisht formes se fajit apo pakujdesise. Punemarresi do te pergjigjet edhe te ne baze te nenit 156 te Kodit Civil.

13.5.Punedhenesi ne dhenien e sanksioneve te percaktuara ne piken 13.2 te kesaj kontrate, ka te drejte te vleresoje masen qe do te ndermerret ndaj Punemarresit, pa qene i detyruar qe per çdo shkelje te ndjeke renditjen e percaktuar per keto masa ne piken e siperpermendur.

## **Neni 16** **Zgjidhja e kontrates**

14.1. Ne rastet kur punemarresi i nenshtrohet proves, zgjidhja e kontrates gjate kohes se proves behet kur Punemarresi nuk permbush prioritetet dhe kerkesat e Punedhenesit per detyren qe eshte kontraktuar.

Punedhenesi mund te zgjidhe kontraten duke njoftuar Punemarresin per zgjidhjen e kontrates 5 dite perpara.

Punemarresi mund te zgjidhe gjithashtu kontraten gjate kohes se proves duke njoftuar Punedhenesin per zgjidhjen e kontrates 5 dite perpara.

14.2 Kontrata me kohëzgjatje të caktuar përfundon në fund të kohës së caktuar. Nëse kontrata zgjatet në heshtje të kohës së caktuar, ajo konsiderohet si kontratë me afat të pacaktuar. Zgjidhja e kontratës me kohëzgjatje të caktuar para afatit, konsiderohet zgjidhje e menjëhershme e saj.

14.3. Punedhenesi ka te drejte te zgjidhe kontraten me kohëzgjatje të pacaktuar duke njoftuar Punemarresin:

- a. dy jave perpara, nese ai ka kryer deri ne gjashte muaj pune prane tij,
- b. 1 muaj para, nëse ka mbi gjashte muaj deri ne dy vjet pune,
- c. 2 muaj para, nëse ka 2-5 vjet pune,
- d. 3 muaj, nëse ka me shume se 5 vjet pune.

14.4. Punedhenesi ne zgjidhjen e kontrates se punes me kohëzgjatje të pacaktuar zbaton rregullat e percaktuara ne nenin 144 te Kodit te Punes, me përjashtim të rasteve kur kemi një zgjidhje të menjëhershme të justifikuar sipas nenit 153 të Kodit të Punës.

Në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të caktuar, përpara përfundimit të afatit, zbatohet procedura e përcaktuar në nenin 144 të këtij Kodi.

14.5. Kontrata zgjidhet ne rastet e meposhteme:

1. Me marreveshje ndermjet paleve;
2. Punemarresit i ka lindur e drejta per perfitimin e pensionit te pleqerise;
3. Kur shoqeria falimenton;
4. Ne rastet e ristrukturimit te ndermarrjes si domosdoshmeri e veprimtarise ekonomike te saj;
5. Kur Punemarresi nuk i pergjigjet kerkesave te punes dhe kerkesave te vazhdueshme te kualifikimit profesional per te cilat ai eshte zotuar per kryerjen e detyres/punes se pershkruar ne kete kontrate;

14.6 Punedhenesi mund ta largoje nga puna Punemarresin per keto arsye:

- a. Kur shkel detyrimet e parashikuara ne kete kontrate individuale te punes;
- b. Kur i provohet fajesia ligjerisht per ndonje veper penale ne ngarkim te tij dhe denohet me vendimin e formes se prere te Gjykates;
- c. Kur nuk zbaton rregulloren e shoqerise ku punon dhe shkel ne menyre te perseritur disiplinën e punes, megjithe paralajmerimet e punedhenesit, si dhe nese punemarresi kryen mungesa te perkohshme gjate orarit te punes pa njoftuar paraprakisht punedhenesit, ose mungon pa shkaqe te arsyeshme;
- d. Kur nuk zbaton rregullat dhe masat mbrojtese te sigurimit teknik ne pune, ne menyre te perseritur;
- e. Kur provohet se shperdoron dhe demton pasurine e shoqerise;
- f. Kur nxjerr sekretet e veprimtarise se shoqerise per te cilat ai eshte ne dijeni;
- g. Kur provohet se mashtrimi i punemarresit i sjell dem shoqerise.

14.7. Punedhenesi dhe punemarresi ne cdo kohe mund te zgjidhin kontraten e punes per shkaqe te justifikuara, sipas percaktimeve te nenit 153 te Kodit te Punes.

### **Neni 17** **Forcat madhore**

15.1. Asnje pale nuk do te jete pergjegjese, nese permbushja e nje cfaredo detyrimi, afati apo neni te kesaj kontrate, eshte bere me vonese, eshte penguar apo nuk eshte permbushur si rezultat i nje ngjarje apo force madhore.

15.2. Ngjarje e forces madhore ne kuptim te kesaj kontrate do te konsiderohen konfliktet e permasave te medha, zjarret, permbytjet, forcat natyrore, apo çdo shkak tjeter jashte kontrollit te pales, ku permbushja e detyrimit prej seciles prej paleve eshte e lidhur apo e ndervarur prej tyre, dhe te cilat pala nuk mund ti menjanonte duke perdorur kujdes te arsyeshem.

**Neni 18**  
**Ndryshimet e kontrates**

16.1.Kontrata, te drejtat dhe detyrimet qe burojne prej saj nuk mund t'i transferohen asnje subjekti tjetër, jashte atyre te percaktuar ne pjesen hyrese te saj.

16.2. Çdo shtese apo ndryshim ne afatet dhe kushtet e kontrates do te behet në marreveshje me shkrim të të dyja palëve.

**Neni 19**  
**Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

17.1. Mosmarreveshjet e lindura ndermjet paleve per çdo keqkuptim, shkelje, keqintepretim apo zbatim te gabuar, te dispozitave te kesaj kontrate, palet do te perpiqen t'i zgjidhin ne mirekuptim ndermjet tyre.

17.2.Pala ankuese duhet t'i drejtoj pales tjetër pretendimet e saj, e cila brenda 10 diteve duhet te ktheje pergjigje lidhur me to.

17.3.Ne rast se mosmarreveshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim, palet kane te drejte t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Tirane, e cila do te jet gjykata kompetenete per zgjidhjen e tyre.

**Neni 20**  
**Njoftimet**

Çdo njoftim apo komunikim i kerkuar apo i lejuar per tu dhene ne baze te kesaj kontrate, do t'i jepet personalisht pales, ne adresen e percaktuar me siper ne kontrate

**Neni 21**  
**Dispozita te fundit**

1. Punemarresi ka te drejte te perzgjedhe kushtet me te favorshme te kontrates kolektive te punes.

2. Kjo kontrate hartohet ne dy kopje ne gjuhen shqipe dhe firmoset me vullnetin e lire te seciles pale. Kopjet e kontrates i vihen ne dispozicion seciles pale.

**PUNEDHENESI**

---

**PUNEMARRESI**

---